



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-116**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-048 PËR  
MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, I  
NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-221**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-048  
PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË,  
I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-221**

**Neni 1**

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.1., përkufizimi “PCN” fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.1. pas përkufizimit “Ndërrmarrje” shtohet përkufizimi i ri “AEL” me tekstin si në vijim:

**AEL** - nënkupton Asistencë Emergjente të Likuiditetit.

## Neni 2

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.5. riformulohet me tekstin si në vijim:

4.5. Thesari udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm. Ministri është i autorizuar që ta emërojë Drejtorin e përgjithshëm. Ministri duhet që së pari të sigurojë që personi përkatës (i) ka përvojë të konsiderueshme në veprimtari bankare dhe/ose të pagesave financiare, (ii) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, (iii) nuk ushtron ndonjë detyrë në ndonjë post udhëheqës ose post tjetër domethënës në ndonjë parti politike, dhe (iv) ka karakter të përshtatshëm moral dhe përvojë profesionale.

2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafët 4.6., 4.7. dhe 4.9. riformulohen me tekstin si në vijim:

4.6. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm është pesë (5) vjet. Drejtori i Përgjithshëm mund të ri-emërohet për një (1) ose më shumë mandate pesë (5) vjeçare shtesë. Ministri mundet, pas pëlqimit me shkrim të Kryeministrit, ta shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm nga ky post para skadimit të mandatit pesë (5) vjeçar, vetëm nëse ka arsye të mira dhe të justifikueshme, të cilat mund të përfshijnë cilëndo nga të mëposhtmet:

a) Drejtori i Përgjithshëm në mënyrë të vazhdueshme tregon se atij/asaj i mungon kompetenca e domosdoshme për të administruar në mënyrë profesionale me thesarin dhe veprimtarinë e tij;

b) Drejtori i Përgjithshëm ka dështuar në ushtrimin e kujdesit të arsyeshëm profesional për të siguruar që veprimet e tij/saj dhe veprimet e personelit të Thesarit janë në përputhje dhe të autorizuara me ligj;

c) Drejtori i Përgjithshëm në mënyrë të vazhdueshme ka dështuar që ti përmbushë detyrimet e tij/saj sipas pikave a) dhe/ose b) të paragrafit 2. të këtij neni; ose

d) Drejtori i Përgjithshëm është angazhuar në vepra të cilat përfshijnë konflikt të interesave; ose

e) Drejtori i Përgjithshëm ka lejuar që personeli i Thesarit të angazhohet në një veprë për të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka qenë në dijeni se përfshin konflikt të interesave, ose për cilën Drejtori i Përgjithshëm, përmes ushtrimit të përkujdesjes të arsyeshme menaxheriale, është dashur të dijë se përfshin konflikt të interesave.

4.7. Nëse Ministri, pas pranimit të pëlqimit nga Kryeministri, e ushtron të drejtën e tij/saj për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Ministri duhet t'i dorëzojë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë me shkrim në të cilën duhet të theksohen arsyet e shkarkimit së bashku me një kopje të pëlqimit të Kryeministrit për shkarkimin. Nëse personi i shkarkuar konsideron se shkarkimi nuk ka bazë të arsyetueshme juridike, ky person

mund t'i drejtohet gjykatës kompetente me qëllim të shqyrtimit të këtij rasti; dhe gjykata është e autorizuar që të marrë çfarëdo masa të cilat i konsideron të ligjshme dhe adekuate.

4.9. Drejtori i Përgjithshëm është i detyruar që në bazë vjetore, t'i dorëzojë Ministrit, Kuvendit, Qeverisë, komunave dhe Kryeministrit një raport vjetor mbi të gjitha çështjet që ndërlidhen me veprimtarinë e Thesarit si dhe zbatimin e Rregullave KMF dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Ky raport duhet të përmbajë një dispozitë (i) në të cilën përshkruhen problemet kryesore në veprimtarinë e Thesarit, zbatimin e Rregullave KMF dhe Buxhetit të Republikës së Kosovës, dhe (ii) në të cilën Drejtori i Përgjithshëm jep rekomandime për zgjidhjet e mundshme të këtyre problemeve.

### **Neni 3**

Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 18.4. shtohet paragrafi i ri 18.5. me tekstin si në vijim:

18.5. Thesari themelon fondin special të rezervave për asistencë emergjente të likuiditetit të sistemit financiar. Fondi special i rezervave për asistencë emergjente të likuiditetit të sistemit financiar, mbahet në llogari të Bankës Qendrore të Kosovës dhe qeveriset dhe administrohet nga Banka Qendrore në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Mjetet e fondit AEL nuk mund të tërhiqen nga Thesari pa pëlqimin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Këto fonde do të konsiderohen pjesë e bilancit bankar të Fondit të Konsoliduar të Kosovës.

### **Neni 4**

1. Neni 81 i ligjit bazik, shtohet paragraf i ri 81.1. me tekstin si në vijim:

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

2. Neni 81 i ligjit bazik, paragrafët 81.1., 81.2. dhe 81.3. rinumërohen si 81.2., 81.3. dhe 81.4.

## **Neni 5**

Pas nenit 80 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 80.A me tekstin si në vijim:

### **Neni 80.A Dispozitat kalimtare**

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me kompetencat e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, do të hyjnë në fuqi me mbarimin e mandatit të Zyrës Civile Ndërkombëtare.

## **Neni 6 Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-116  
14 qershor 2012**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**